

Besim dhe arsye

Jezusi kurrë nuk u kërkoi njerëzve që të besonin pa arsye dhe dëshmi se ai është Biri i Perëndisë. Ai iu referua të vërtetave që njerëzit pranuan. Ai u kërkoi që ta pranonin mbi bazën e dëshmimeve të njohura. Midis të tjerash, dëshmitë që ai përdori ishin: (1) Gjoni, të cilin njerëzit e pranuan si profet (Gjoni 5:33); (2) veprat e Tij (Gjoni 5:36); (3) dëshmia e Atit (Gjoni 5:37); (4) dëshmia e Fjalës (Gjoni 5:38); (5) dëshmia e Shkrimeve (Gjoni 5:39, 46, 47); (6) fuqia e dukshme e të vërtetës kur vihet në provë në jetën e njerëzve (Gjoni 7:17) dhe (7) dëshmia e ringjalljes (Romakëve 1:4). Të gjitha këto gjëra, por edhe të tjera, dëshmojnë për Krishtin. Kredencialet e tij na janë paraqitur dhe na është bërë thirrje që t'i shqyrtojmë me kujdes.

Atij që beson te Jezu Krishti nuk i kërkohet që të lërë mënjanë fuqinë për të arsytuar dhe të pranojë çdo gjë që pretendon se është nga Perëndia. Fjalët e Palit, të shkruara për kristianët, mund të mbishkruhen shumë mirë në çdo laborator shkencor: “Provoni të gjitha, mbani të mirën” (1 Thesalonikasve 5:21; shiko 1 Gjon 4:1). Meqënëse besimi nuk është mospranim i çdo gjëje që shikojmë, ç’do të thotë atëhere të ecësh nëpërmjet besimit dhe jo nëpërmjet asaj që shikon?

Besimi vjen nga dëgjimi i fjalës së Krishtit (Romakëve 10:17). Fjala e tij na paraqet dëshminë e vërtetësisë së besimit kristian. Kur përdorim arsyen për të vlerësuar këtë dëshmi, shohim se ka prova të mjaftueshme për të pranuar Krishtin dhe se ka prova të pamjaftueshme për të bërë të kundërtën. Kur faktet na çojnë të besojmë te Krishti dhe kur ajo që shohim dhe provojmë na bën që të nxjerrim si përfundim se ai është Biri i Perëndisë, ne e vendosim mirëbesimin tonë tek ai dhe në këtë mënyrë te Fjala e tij. Ky është një mirëbesim i tillë që e bën besimtarin të dojë të besojë te Perëndia dhe të zbatojë urdhërimet e tij, madje edhe ato urdhërimet që nuk mund t'i kuptojë me arsyen e tij të kufizuar njerëzore.

Ky parim, në fakt, është ai që përdorim shpesh në lidhje me njerëzit e tjerë. Kemi besim apo mirëbesim te disa njerëz të caktuar, sepse njohja dhe marrëdhëniet e mëparshme me ta na bëjnë që t'i respektojmë dhe të kemi besim në ta. Në qoftë se

kemi besim tek ata atëherë kemi besim edhe në fjalën e tyre. Ajo që kemi parë tek ata na bën që të bazohemi në fjalën e tyre, edhe për ato çështje që s’mund t’i hetojmë vetë. Tamam kështu, të gjitha faktet lidhur me Krishtin na tregojnë se ai është Biri i Perëndisë dhe si rrjedhim e meriton t’i besosh. Gjithçka që mund të mësojmë për Krishtin na bën që të kemi besim tek ai. Prandaj, kur lexojmë atë që ai ka thënë për përjetësinë (që ne s’mund ta hetojmë vetë) dhe për rrugën që duhet të ndjekim që të jetojmë me Perëndinë, ne i besojmë fjalës së tij.

Përveç nevojës për besim, në besimin kristian funksionon edhe arsyeja në tri mënyrat e mëposhtme:

Së pari, ne kërkojmë të gjejmë prova të tjera që tregojnë se mësimet e Krishtit janë të vërteta dhe hetojmë kundërshtimet e bëra për të. Shohim se ato nuk janë të vërteta, sepse bazohen mbi hipoteza të gabuara ose mund të jenë ndërtuar gabim. Edhe ato kundërshtime që mund të jenë të vërteta nuk mund të çenojnë kredencialet e Krishtit. Ato mund të jenë komplet të palidhura me Krishtin.

Së dyti, arsyeja vazhdon të funksionojë edhe kur na është thënë të bëjmë një studim inteligjent të Shkrimeve për të kuptuar se çfarë na thotë Perëndia.

Së treti, Bibla nuk na jep udhëzime të veçanta në çdo çështje, por na jep një parim që duhet zbatuar. Pastaj, duhet të përdorim inteligjencën për ta zbatuar parimin sa më mirë që të jetë e mundur në kushtet e dhëna. Për shembull, “rregulla e artë” (Mateu 7:12) nuk e thotë me saktësi se ç’duhet bërë ndaj të tjerëve, por na udhëzon që t’u bëjmë atyre gjithçka që dëshirojmë të na bëjnë. Se ç’kuptim ka kjo në situata të caktuara nuk na jepet nga parimi. Përkundrazi, ne duhet ta zbatojmë parimin sipas situatës tonë, që mund të mos jetë tamam si situatat e përmendura në Bibël.

Arsyeja duhet të vazhdojë të funksionojë. Ajo ka një punë të bollshme dhe frytdhënëse në jetën e kristianit. Një jetë e tillë na ofron mundësi të panumërta për të menduar thellë. Ka sfera të mëdha në jetën e kristianit për të cilat Krishti nuk ka vënë ligje specifike. Le t’i zbatojmë me besim parimet duke i vendosur në themel të jetës sonë.

Autor: *David Roper*

Marrë nga studimi: *“Udhëzues për shpëtimin e të gjithëve”*

© 2001, 2003 E VERTËTA PËR SOT

Të gjitha të drejtat të rezervuara